



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Mars 2022

Nr: 122

V E N D I M

P Ë R

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 87, DATË 19.2.2022, TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE, “PËR AKREDITIMIN E GAZETARËVE DHE OPERATORËVE TË “REPORT TV”, PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022”

Sot, më datë 4.3.2022, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: “Report TV”, me seli në Tiranë, Rruga “Niko Pushkin” dhe përfaqësuese zj. Vilma Theodhosi.

OBJEKTI: Për një shtesë në vendimin nr. 87, të datës 19.2.2022, për akreditimin si vëzhgues të gazetarëve dhe operatorëve për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 64, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimi nr. 2, datë 2.2.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore” dhe vendimi nr. 2, datë 22.1.2022, i Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 mars 2022”.



Data: 4 Mars 2022

Nr. 122

“Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 19.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për akreditimin e gazetarëve dhe operatorëve të “Report TV”, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”

VËREJ:

Televizioni “Report TV” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin 7 (shtatë) gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Me vendimin nr. 87, datë 19.2.2022, të ndryshuar, janë akredituar 81 (tetëdhjetë e një) gazetarë dhe operatorë të Report TV. Në kërkesën e paraqitur më datë 3.3.2022, kërkohet një shtesë për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve dhe operatorëve.

Kërkesa fillestare e Report TV është dorëzuar brenda afatit procedural të përcaktuar në pikën 11 të vendimit nr. 2/2022 të Komisionit Rregullator. Televizioni “Report TV”, është subjekt i cili gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje të përcaktuar në nenin 6, pika 2, të Kodit Zgjedhor dhe përmbush kushtin ligjor.

Në zbatim të nenit 64 të Kodit të Procedurave Administrative, pala që ka dorëzuar një kërkesë mund ta plotësojë ose ndryshojë atë, vetëm kur qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike si kërkesa fillestare.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 64 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimin nr. 2, datë 2.2.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore” dhe vendimin nr. 2, datë 22.1.2022, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, që do të zhvillohen më datë 6 mars 2022”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve



V E N D O S I:

1. Akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, të 7 (shtatë) gazetarëve dhe operatorëve të Report TV, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Shtesa e miratuar do t'i shtohet listës nr. 1 të gazetarëve dhe operatorëve, të miratuar në vendimin nr. 87, datë 19.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të ndryshuar.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

